



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR

Për: “Alen&Co ” sh.p.k

Adresa: Fier, Zharrës Rruga Fier- Berat km 10, Godina nr.7 Hyrja nr.2 ,kati 1 .

Për:”2RC”sh.p.k

Adresa:Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5 ,Rruga Pashko VASA, pallati nr.8.

Për:“A.M.U” sh.p.k.

Adresa: Durrës Fushë-Krujë,Autostrada Fushë-Krujë Laç, km 1,5.

Për:“WESTEC” sh.p.k.

Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake nr.11 ,Rruga Lule Bore , Banesë Private nr.17.

Për:”Anton Marku p.f”

Adresa: Durrës,Kodër Thumanë, Derven banesë private 2 katëshe në të majtë të rrugës Fushë-Krujë, Laç km 4.

* * *

Procedura e prokurimit: “Blerje Elektropompa për nevoja të Shoqërisë”

Numri i referencës së procedurës/lotit:**REF-46167-12-13-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Elektropompa për nevoja të Shoqërisë”Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara me vlerë të pritshme 14,596,911(katërmëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë)lekë pa tvsh dhe shumatore të çmimeve për njësi 12,352,666(dymbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë)lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomiksht më e favorshme çmimi më i ulët X(Shumatorja e cmimeve për njësi)

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1."Klosi –R Company"L72120030I

Shumatorja e cmimeve për njësi 7,440,000(shtatë milion e katërqind e dyzetë mijë)lekë pa tvsh.

2. Alen&Co " sh.p.k K83213401M

Shumatorja e cmimeve për njësi 9.672.555 (nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë)lekë pa tvsh

3.2RC"sh.p.k K82303007K

Shumatorja e cmimeve për njësi 10.248.200 (dhjetë milion e dyqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind)lekë pa tvsh.

4.A.M.U" sh.p.k.K14229210F

Shumatorja e cmimeve për njësi 11.342.500(njëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

5.Novamat sh.p.k K81615002O

Shumatorja e cmimeve për njësi 11.111.111(njëmbëdhjetë milion e njëqindë e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë)lekë pa tvsh

6.WESTEC" sh.p.k.L01621002O

Shumatorja e cmimeve për njësi 12.352.000(dymbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë)lekë pa tvsh.

7.Anton Marku p.f L03817203B

Shumatorja e cmimeve për njësi 12.352.600(dymbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1.Novamat sh.p.k K81615002O

Shumatorja e cmimeve për njësi 11.111.111(njëmbëdhjetë milion e njëqindë e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë)lekë pa tvsh

Përkatësisht për arsytet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur me gabime aritmetike në vlera.

Referuar nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet shprehimisht: “Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. **Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruara.**

Konkretisht operatori ekonomik në formularin e ofertës ka deklaruar vlerën prej 11,111,111 (një mbëdhjetë milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë)lekë pa tvsh.

Gjatë kontrollit të ofertës ekonomike për gabime aritmetike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se nga mbledhja e vlerave të operatorit ekonomik shuma totale e çmimeve për njësi në të vërtetë rezulton 10.526.111(dhjetë milion e pesëqind e njëzetë e gjashtë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë)lekë pa tvsh,pra rezulton një diferencë prej 585.000(pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë)lekë pa tvsh.

Pra siç cituam më lart nga veprimet aritmetike të kryera të të gjithë ofertës të paraqitur, rezulton se oferta e operatorit ekonomik ankimes ka gabime aritmetike, pas mbledhjes së nëntotaleve të përcaktuara në preventiv, **gabime këto që tejkalojnë vlerën 2% të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar nga ky i fundit.**

Në këto kushte, bazuar në përcaktimin ligjor si më sipër cituar, meqenëse gabimet janë më të larta se 2 % e vlerës së ofruar, gjykojmë se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Novamat sh.p.k ” sh.p.k. refuzohet menjëherë.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

2..”Klosi –R Company” L72120030I

Shumatorja e cmimeve për njësi 7,440,000(shtatë milion e katërqind e dyzetë mijë)lekë pa tvsh.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 56 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit verifikoi nëse oferta e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik”Klosi-R Company”sh.p.k është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.

Në këto kushte në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643,date 20.11.2006”Per Prokurimin Publik”i ndryshuar shprehimisht citohet se

1)Kur AK vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave ,punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për

elementet e veçantë të ofertës për:

Në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar KVO- më datë 30.01.2020 i dërgoi shkresë operatorit ekonomik "Klosi-R Company" sh.p.k me qëllim depozitimin e dokumentacionit provues dhe argumentimin me shkrim të ofertës anomalisht të ulët brenda 3 ditëve punë.

Më datë 01.02.2020 nëpërmjet mesazheve elektronike në sistemin elektronik u konstatua se operatori ekonomik "Klosi-R Company" sh.p.k ka bashkëngjitur shkresën me lëndë "Sqarim mbi Ofertën Anomalisht të Ulët".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik nuk ka respektuar formën e kërkuar nga ligji përkatësisht neni 56 pika 1 në të cilën parashikohet se....

Kur AK vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e veçantë të ofertës.

Bëjmë me dije se në mbështetje të dispozitave ligjore të mësipërme si dhe shkresës së dërguar nga AK operatori ekonomik pjesëmarrës ka qënë i detyruar të zbatojë formën e kërkuar sipas nenit 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pra, duke paraqitur sqarimin mbi ofertën anomalisht të ulët shoqëruar me prova shkresore me shkrim pranë AK.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se operatori ekonomik ka dështuar në dorëzimin e dokumentacionit me shkrim pranë AK.

Gjithashtu në bazë të nenit 66 pika 5 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik" shprehimisht citohet se....

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së.

Përsa më sipër, theksojmë se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe **paraqitjen e dokumentacionit me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor iu përket operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Rrjedhimisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët dhe depozitimi i dokumentacionit në respektim të formës së kërkuar në nenin 56 të LPP-së dhe nën 66 pika 5 të VKM nr.914, ndaj dokumentacioni i paraqitur në mënyrë elektronike në S.P.E nga ky operator do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në shqyrtim nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. Alen&Co " sh.p.k K83213401M

Shumatorja e cmimeve për njësi 9.672.555 (nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh

2.2RC”sh.p.k

K82303007K

Shumatorja e cmimeve për njësi 10.248.200 (dhjetë milion e dyqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind)lekë pa tvsh.

3.A.M.U” sh.p.k.K14229210F

Shumatorja e cmimeve për njësi 11.342.500(njëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

4.WESTEC” sh.p.k.L01621002O

Shumatorja e cmimeve për njësi 12.352.000(dymbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë)lekë pa tvsh.

5.Anton Marku p.f

L03817203B

Shumatorja e cmimeve për njësi 12.352.600(dymbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind)lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë UKT sh.apranë Drejtorisë së Prokurimeve brenda 60(gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.02.2020

Njoftimi i Riklasifikimit është bërë në datë 16.04.2020

Ankesa: PO

Më datë 05.02.2020, u bë shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave për procedurën e lartpërmendur. Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender, pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomik “**Klosi- R**” **shpk** hyrë në UKT sh.a me nr. K-399 Prot, datë 10.02.2020, në lidhje me vlerësimin e kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Me marrjen e ankesës së operatorit të mësipërm në mbështetje të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në VKM-në Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, Kreu X, Neni 78, pika 2, me Urdhërin nr. 28689/9 datë 07.02.2020, u pezullua procedura sipas legjislacionit në fuqi, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP.

Gjithashtu në mbështetje të pikës 6/a të Kreut X të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me urdhër 28689/10 datë 07.02.2020, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave i cili pasi u njoh me pretendimet e Operatorit Ekonomik “**Klosi-R- Company** ” **shpk** konkludoi në mospranimin e ankesës.

Më datë 19.02.2020 operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik .

Më datë 06.04.2020 pranë UKT sh.a protokoll hyrës nr. 930 është depozituar vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik i cili ka vendosur përsëritjen e kërkesës për sqarim oferte anomalisht të ulët për procedurën me objekt “Blerje Elektropompa për Nevoja të Shoqërisë” drejtuar operatorit ekonomik Klosi-R Company sh.p.k.

Në zbatim të vendimit të KPP-së më datë 07.04.2020 Autoriteti Kontraktor UKT sh.a dërgoi shkresë operatorit ekonomik “Klosi-R Company” sh.p.k kërkesën për sqarim oferte anomalisht të ulët në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643,date 20.11.2006”Per Prokurimin Publik”i ndryshuar.

Më datë 10.04.2020 prot hyrës nr. 6505 operatori ekonomik depozitoi shkresën me lëndë”Kthim përgjigje shkresës nr.prot 28689/115 për sqarim oferte anomalisht të ulët”

Komisioni i Vlerësimit të ofertave pasi mori në shqyrtim materialin e depozituar nga ana e operatorit ekonomik vëren se :

Nisur nga sa më sipër, shoqëria “Klosi-R Company ” shpk, sqaron se kjo shoqëri, operon ne tregun formal të tregtimit me shumicë dhe pakicë të artikujve .

Sipas argumentimit të operatorit ekonomik “Klosi- R Company ” shpk, bilanci është rentabël, me kapacitete të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare.

Shoqëria jonë përpara se të konkuroj në një procedurë marrim ofertë tek prodhuesi siç ka ndodhur në rastin objekt prokurimi.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga “Klosi-R-Company”sh.p.k KVO konstaton se ka bashkëngjitur vetëm analizën e çmimeve shoqëruar me fatura doganore të lëshuar nga prodhuesi.

KVO vëren se operatori ekonomik “ Klosi-R Company ”sh.p.k përveç argumentimit të vet në formën e një preventivi vetdeklarativ, ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës por jo prova bindëse sikurse është kërkuar.

Në këtë kuptim KVO gjykon se analiza e cmimeve si dhe faturat e zhdoganimit të paraqitur nga operatori ekonomik nuk janë më se të mjaftueshme për autoritetin kontraktor për krijimin e bindjes për realizimin e minikontratës objekt prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori pjesëmarrës ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues si: fletë zhdoganimi për mallrat objekt prokurimi por nuk ka paraqitur kontrata mallrash , kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, me çmime të ulëta sic ka ofertuar në procedurën objekt prokurimi me qëllim vërtetimin para Autoritetit Kontraktor UKT sh.a se pavarësisht cmimit të ulët operatori ekonomik Klosi R Company sh.p.k ka realizuar dhe kontrata me sukses edhe me autoritete të tjera kontraktore.

Referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por

gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj.

Sqarojmë se risku që mund të shfaqet nga një ofertë anomalisht të ulët është në disa drejtime nga të cilat përmendim rrezikun për mos kryerjen e furnizimit në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e minikontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e furnizimit brenda afateve kohore të parashikuara, në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Në këtë kuptim KVO gjykon se analiza e cmimeve si dhe faturat e zhdoganimit të paraqitur nga operatori ekonomik nuk janë më se të mjaftueshme për autoritetin kontraktor për krijimin e bindjes për realizimin e minikontratës objekt prokurimi me sukses.

Operatori ekonomik ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e furnizimit pranë autoritetit kontraktor.

Gjithashtu nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar, nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e furnizimit në referim të germës ç, neni 56 pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi provueshmëria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e furnizimit por për realizimin e tij sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurues të ofertuar.

Operatori ekonomik duhej të paraqiste para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e mallrave, origjinalitetin e mallrave të propozuar, **si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.**

Referuar shkresës së paraqitur pranë AK operatori ekonomik vetëm ka përmendur se shoqëria ka kapacitet njerëzor por nuk ka bashkëngjitur dokumentacion provues mbi zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen dhe kushtet e punës ku do të sigurohet furnizimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.02.2020

Njoftimi i Riklasifikimit është bërë në datë 16.04.2020

Ankesa: PO

Ankesa mbi Riklasikimin :JO